



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë Ligjor
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	8
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	12/01/2022
Afati për aplikim	27/01/2022 - 03/02/2022
Institucioni	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
Departamenti	Departamenti Ligjor
Divizioni	
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00008048
Kodi	RPC0001849

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Detyra 1: Përfaqësimi i KPMM-së në Gjykatë në procedurë penale, civile dhe administrative

Detyra 2: Përgatitja e shkresave administrativo-juridike për dhe në emër të institucionit për gjykata në cilësinë e përfaqësuesit të KPMM-së.

Detyra 3: Përgatitja e akteve juridike sipas vendimeve të Bordi i KPMM-se dhe Drejtorit të KPMM-së;

Detyra 4: Përgatitja e kallëzimeve penale, aktvendimeve administrative – gjobave, padive civile dhe administrative, përgjigjeve në padi, propozimeve për përmbarrim, prapësimeve, përgjigjeve në prapësim, ankesave dhe përgjigjet në ankesa etj.

Detyra 5: Përgatitja e rregulloreve, direktivave, dhe udhëzimeve sipas vendimeve të Bordit, duke

përfshirë legjislacionin sekondar minerar sa i përket fushës juridike minerar si dhe

mbrojtjes në punë në sektorin e minierave.

Detyra 6: Pjesëmarrja në organe kolegjiale për trajtimin e kërkesave apo ankesave drejtuar KPMM- së;

Detyra 7: Përgatitja e raporteve ligjore për aplikacionet për licenca/leje për Bordin e KPMM-së;

Detyra 8: Detyra te tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret– të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS (sistemi 4 vjeçar) apo Diplomë Bachelor të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me 180 kredi/ECTS (sistemi 3 vjeçar) me kusht që të ketë të përfunduar studimet Master në Fakultetin Juridik.
- Trajnime në fushën relevante.
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale juridike në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.
- Dëshmia për përvojën e punës duhet dëshmuar me pasqyrën e llogaris nga Trusti ose Qarkores në fuqi.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën e legjislacionit në sektorin e minierave;

Nivel të lartë të njohurive profesionale të fushës në sektorin e minierave dhe të kuptuarit të fushave së administrates publike dhe gjyqësorit për shkak që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit e pozitës;

Njohuri të gjera të fushës juridike, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;

Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesional

Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

Njohja e gjuhës angleze apo gjuhëve të tjera që gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës është përparësi.

•

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 10/02/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Zyret e KPMM-ës, Prishtinë



8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Diplomë të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS (sistemi 4 vjeçar) apo Diplomë Bachelor të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me 180 kredi/ECTS (sistemi 3 vjeçar) me kusht që të ketë të përfunduar studimet Master në Fakultetin Juridik.
- Trajnime në fushën relevante.
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale juridike në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

